

# **SKEMË për punë (gjysmëvjetori i parë)**

**Shkencat natyrore**

**Klasa e II-të**

# Udhëzim për planifikimin e mësimit në Shkencat natyrore për klasën e dytë

## Hyrje

Dokumenti paraqet një skemë, përkatësisht planë për realizimin e programit mësimor për shkencat natyrore për klasën e dytë.

Objektivat arsimore grupohen në tema, gjegjësisht njësi mësimore në gjysmëvjetorin e parë.

Radhitjen e realizimit të temave mund ta ndryshoni në pajtueshmëri me kushtet lokale dhe sipas resurseve që posedoni.

Skema bazohet në 16 javë pune në gjysmëvjetorin e parë.

Objektivat të cilat i referohen hulumtimeve shkencore përsëriten, përkatësisht paraqiten në çdo njësi për mësim dhe janë të radhitura në fillim të çdo njësie.

Pastaj vijnë objektivat për të mësuar, të cilat i referohen temave konkrete të njësive.

Objektivat janë të shoqëruara me aktivitete dhe resurse përkatëse (mjete dhe materiale) për të treguar mënyrën e realizimit.

Gjysmëvjetori i parë
Tema 2.1 Drita dhe errësira
Tema 2.2 Energjia elektrike
Tema 2.3 Ndryshimi i materialit

## **TEMA: 2.1 Drita dhe errësira**

Kjo temë u ndihmon nxënësve të kuptojnë se kemi nevojë për dritë që të mund ti shohim objektet. Nxënësit do të mësojnë se errësira është mungesa e dritës. Nxënësit mundet të kuptojnë se në mungesë të dritës diellore burimet e tjera të dritës mund të shihen më lehtë. Nxënësit kanë mundësi që të lidhin kuptimin e tyre shkencor me eksperiencën e përditshme për dritën dhe errësirën. Mund të bëhet lidhje me edukimin fizikë në kontekstin e të menduari për shëndetin dhe sigurinë.

Hulumtimi shkencorë është fokusuar në:

- dhënien e rekomandimeve se si duhet të hulumtohen idetë;
- vëzhgimi dhe krahasimi;
- shpjegimin e mendimeve të tyre.

Qëllimet e mësimit	Nocionet
<p><b>Ide dhe fakte</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbledhë të dhëna përmes vëzhgimit kur përpiqen që ti përgjigjen ndonjë pyetje shkencore</li> <li>- shfrytëzon provojnë e përditshme, p.sh vëzhgimin e shkrirjes së akullit</li> <li>- shfrytëzon burime informacioni të thjeshta.</li> </ul> <p><b>Marrja dhe paraqitja e provave</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- jep sugjerime për mbledhjen e provave.</li> <li>- fletë për rreziqet dhe si ti anashkalojmë të njëjtat.</li> <li>- vëzhgon dhe mbanë shënim vëzhgimet.</li> <li>- bën matje të thjeshta .</li> <li>- përdorë mënyra të ndryshme për tu treguar të tjerëve çfarë ka ndodhë.</li> </ul> <p><b>Shqyrtimi i provave dhe qasjet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- bën krahasime.</li> <li>- identifikon modele të thjeshta dhe asociacione</li> <li>- bisedon për parashikimet ( gojarisht dhe me teste), për rezultatet dhe pse ata kanë ndodhur.</li> <li>- rishikon dhe shpjegon çfarë ka ndodhur.</li> </ul>	<p>Dritë Errësirë Dielli Llambë xhepi</p> <p><b>Hulumtime shkencore</b></p> <p>Shikon Tregon Pyet E qëllon I drejtë Jo i drejtë Peshon krahason</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
Fizika (Drita dhe errësira)			
<p><b>Java e 1</b> Identifikon burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin. <b>Hulumtim shkencor, Shqyrtimi i të dhënave dhe qasjes</b> Bën krahasime</p>	<p><b>Ora e 1: Burimet e dritës</b></p> <p>Në çifte nxënësit diskutojnë se prej nga vinë drita. Pastaj i tregojnë mendimet e tyre, arsimtari i mbanë shënim në tabelë ose në flipçart.</p> <p>Bëni hyrje për termin „burimet e dritës” për diçka që prodhon dritë. Pastaj diskutoni për çdo burim të dritës të përmendur nga nxënësit (të shënuara në tabelë), p.sh: Dielli/yjet/ndriçim nga vatra/llambat me vajë/qiri/llambat/drita elektrike etj.</p> <p>Jepuni fleta punë nxënësve në të cilat janë vendosur fotografi nga burime të ndryshme të dritës për ti emërtuar. Jepni më shumë hapësirë nxënësve të japin më shumë ide/shembuj me vizatime ose me shkrimë.</p>	<p>Fotografi (internet dhe libra) për burime të ndryshme të dritës</p>	<p>Nxënësit me problem në shikim do të kenë nevojë për mbështetje të veçantë gjatë kohës së leksionit – mundet të përdorin shqisat e prekjes dhe ta ndjejnë ngrohtësinë e burimit të dritës.</p> <p>E rëndësishme është që arsimtari tu ndihmojë nxënësve të tjerë që të jenë të ndërgjegjshëm për ata që kanë probleme me shikimin.</p> <p>Përshkruani Diellin si burim kryesor të dritës në Tokë. Përshkruani si një top gjigand të djegies së gazit në hapësirë, ajo ndriçon dhe jep dritë (dhe ngrohtësi) e cila udhëton deri në Tokë për të na dhënë dritë.</p> <p>Yjet mund të jenë më të mëdhenj dhe më të vegjël se Dielli – duken më të vogla sa më larg që janë;</p> <p>Drita që shihet si shkarkim energjetik gjatë kohës së stuhive, zjarri vinë gjatë djegies së karburantit; xixëllonjat kanë qeliza të veçanta në trupin e tyre siç e bëjnë peshqit në fundin e detit.</p> <p>Burimet artificial të dritës përfshin ndriçues me vajra, diell, bateri, energji elektrike.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Dritë Errësirë Diell Llambë</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Nocione
Fizika (Drita dhe errësira)			
			Burime (emrat e të gjithë burimeve të dritës të diskutuara ose të shikuara <b>Hulumtimet shkencore</b> Shikon Tregon Shkruan Krahason

<p><b>Java e parë</b> Identifikon burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin. <b>Hulumtim shkencorë</b> <b>Ide dhe prova/fakte</b> Mbledhë prova me vëzhgime kur mundohet ti përgjigjet ndonjë pyetje shkencore.</p>	<p><b><u>Ora 2: Burime natyrore dhe artificiale të dritës</u></b></p> <p>Përsëriteni emrat të disa nga burimeve të ndryshme të dritës nga ora paraprake.</p> <p>Tregoni nxënësve se burimet natyrore të dritës krijon / prodhojnë dritë. Në çifte nxënësit duhet të numërojnë burime natyrore të dritës.</p> <p>Me të gjithë klasën realizohet diskutim se prej nga vjen drita (prej të gjithë burime natyrore të dritës të përmendura, si psh: Dielli/yjet/xixëllonjat/peshqit të cilët jetojnë në thellësitë e detit).</p> <p>Pastaj diskutoni burimet artificial (jonatyrore). Ata mundë të përfshinë: vajrat/ poçet elektrikë dhe diskutoni burimet e dritës për çdo njëri nga ata (p.sh: dielli i qirinjve, betërit për poçet, rryma për poçet elektrikë etj.)</p> <p>Tregoni shembuj për çdo burim të dritës. Bëni këtë aktivitet që të zbulojnë më shumë burime të dritës- <a href="http://www.bbc.co.uk/schools/scienceclips/ages/5_6/light_dark.shtml">http://www.bbc.co.uk/schools/scienceclips/ages/5_6/light_dark.shtml</a></p> <p>Vizatoni katër (ose më shumë) burime të ndryshme të dritës. Nxënësit duhet ti emërtojnë dhe ti klasifikojnë nëse janë burime të dritës natyrore ose artificial.</p>	<p>Zgjedhja e burimeve natyrore dhe artificial – fotografi (libra dhe internet) ose modele ose shembuj nga përditshmëria</p> <p>Letër laps</p>	<p>Përkrahuesi Diellin si burim kryesor të dritës në Tokë. Përkrahuesi si një top gjigante të djegies së gazit në hapësirë, ajo ndriçon dhe jep dritë (dhe ngrohtësi) e cila udhëton deri në Tokë për të na dhënë dritë. Yjet mund të jenë më të mëdhenj dhe më të vegjël se Dielli – duken më të vogla sa më larg që janë; Drita që shihet si shkarkim energjetik gjatë kohës së stuhive, zjarri vinë gjatë djegies së karburantit; xixëllonjat kanë qeliza të veçanta në trupin e tyre siç e bëjnë peshqit në fundin e detit. Burimet artificial të dritës përfshin ndriçues me vajra, diell, bateri, energji elektrike.</p> <p><b><u>Fjalë kyçe / Shprehje</u></b> Burime të dritës Artificial Natyrore Emrat e të gjitha burimeve të dritës të treguara ose diskutuara <b>Hulumtimi shkencor</b> Shikon Krahason</p>
--	--	--	--

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Nocione
Fizika (Drita dhe errësira)			
<p><b>Java e dytë</b> E dini që errësira është mungesa e dritës. <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Ide dhe provat/faktet</b> Shfrytëzo provoja nga përditshmëria, psh vëzhgimin e shkrirjes së akullit. <b>Shqyrtimi i provave dhe qasjes</b> Vështron dhe tregon se çfarë ndodhë.</p>	<p><b><u>Ora 3: Errësira është!</u></b></p> <p>Me ndihmën e një gome të gjallë, vendosin figurë plastike – lojë në vendin ku ndodhet Republika e Maqedonisë në glob. Kërkoni nga një nxënës që të jetë Dielli dhe të ndriçojë në glob (Tokë) me ndihmën e llambës. Tregoni rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj. Në çifte nxënësit diskutojnë për atë çka bëjnë në mbrëmje (psh: flenë, rrinë në shtëpi, nuk punojnë). Diskutoni për vendet e punës me njerëzit të cilët punojnë në ndërrimin e natës psh: taksistë, personeli medicinal, personeli i pastrimit etj.</p> <p>Aktivitet: <u>Kutia e zezë</u>: test që të zbulohet si është/ si duket në errësi. Sa mirë dhe sa keq mund ti shihni objektet në errësi? Shikoni në kuti – shikoni diçka. Vendosni një objekt të shndritshëm në kuti – a shikoni diçka?(jo). Përsëritni me objekte të ndryshme ndriçuese. Përsëriteni aktivitetin me llambë të vogël dhe të vendosur në kuti. Shkruani për objektet që i përdorët në kuti, para dhe pas përfshirjes së ndriçuesit. Si është dallimi?</p> <p>Përkufizoni: errësi është kur nuk ka dritë.</p> <p>Për të vlerësuar se sa nxënësit u kanë kuptuar: luani lojën nata/dita, errësi/dritë. Mund të kërkoni nga nxënësit përmes kolazhit ose fotografive të tregojnë shembuj: “<i>Çfarë mund të shikojmë ditën</i>” ose <i>Çfarë mund të shikojmë natën</i>” Diskutoni se çfarë paraqesin fotografitë e tyre / kolazhet.</p>	<p>Gomë e gjallë Figurë plastike Glob Llambë</p> <p>Kuti e zezë për këpucë Zgjedhja e mjeteve të ndryshme ndriçuese</p> <p>Lapsa dhe letra</p>	<p>Nxënësit shpeshherë nuk kanë eksperiencë me errësinë e plotë dhe ndonjëherë ata mund të shikojnë edhe në errësi sepse dritat e rrugës e ndriçojnë dhomën e tyre kur janë në krevate.</p> <p>Shpjegoni se kur Dielli e ndriçon Maqedoninë, atëherë është ditë, a kur Maqedonia është në hije (larg nga ndriçimi i Diellit) atëherë është natë.</p> <p>Përgatitni më përpara një kuti ose disa kuti, me kapakë, të ngjyrosura me të zezë nga brenda. Bëni një vrimë të vogël për të parë në njërin nga anët më të shkurtra të kutisë (Kutia e këpucëve janë ideale). Jeni të sigurt që të gjithë ndriçuesit punojnë mirë dhe kanë bateri ose poçe si rezervë. <b>Fjalë kryesore / Shprehje</b> Ndriçim/ llamba</p>



Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
Fizika (Drita dhe errësira)			
			Errësirë Llambë <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Tregon Shkruan Krahason
<p><b>Java e dytë</b>            Identifikon burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin. E dinë se errësira është mungesa e dritës.  <b>Hulumtim shkencor</b>  <b>Idetë dhe provat/faktet</b>            Shfrytëzo provoja nga përditshmëria, psh vëzhgimin e shkrirjes së akullit.</p>	<p><b><u>Ora4: Dritat që na ndihmojnë të shikojmë në errësirë</u></b></p> <p>Bisedoni me nxënësit për atë pse kyçen dritat e rrugës kur errësohet, si dhe për atë se cila vende të tjera shfrytëzojnë shumë dritë në darkë.</p> <p>Bëni një listë në sa më shumë lloje të ndryshme të dritave elektrike.</p> <p>Lexoni ose tregoni tregimin për dritën dhe errësirën, psh:(TheOwlWhoWasAfraidof theDark'byJillTomlinson). Bisedoni për atë se si ndiheni në errësirë – shkëmbeni përvojat personale psh: qëndrimi në errësirë, a keni qenë ndonjëherë në shpellë, në tunel etj.</p> <p>Lojë: në çifte, njërit nxënës i vendoset shami tek sytë, ndërsa tjetri e udhëzon duke bërë rrethe nëpër klasë, duke e mbajtur për dore dhe duke i treguar se çfarë duhet të bëjë. Matni se sa kohë i duhet kur i ka sytë e mbyllur dhe sa kurë i ka sytë të palidhura. Sa është dallimi?</p> <p>Përfundimi: Burimet e energjisë të cilat shfrytëzojnë rrymë elektrike kryesisht përdoren natën. Kur errësohet nuk ka dritë.</p>	<p>Flipçart dhe markerë ose tabelë e bardhë</p> <p>Libër me tregime ose video klip e rregulluar në pjesën e lojës si në shpellë</p> <p>Shami për ti lidhur sytë</p> <p>Rrugica të përgatitura nëpër klasë</p>	<p>Drita na ndihmon për të shikuar. Idetë e propozuara që mund të përfshihen: llambat, dritat e rrugës, drita e karnavalit, sinjalizimi rrugor etj.</p> <p>Shtëpitë, aeroportet, spitalet shfrytëzojnë shumë ndriçim në darkë.</p> <p>Zgjidhni një përrallë të njohur që ta tregoni në errësirë. Shpjegoni se vendet janë të errëta nëse nuk ka ndriçim aty</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b>            Dritë            Errët            Natë            Energji elektrike            Burime e dritës  <b>Hulumtime shkencore</b>            Shikon</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
			Pyet Tregon Krahason
<p><b><u>Java etretë:</u></b>            Identifikon burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin. E dinë se errësira është mungesa e dritës.</p> <p><b>Hulumtim shkencor</b>            Fletë për rreziqet dhe si mundë të anashkalohen.</p>	<p><b><u>Shfrytëzimi i sigurt i energjisë elektrike</u></b>            Diskutoni se si mund të jeni të sigurt gjatë shfrytëzimit të energjisë elektrike (shikoni komentimet).</p> <p>Aktivitet: vizatoni edhe emërtoni shembuj të llojeve të ndryshme të energjisë elektrike të cilat i shfrytëzoni në errësirë.</p> <p>Përgatitni poster që të mund të tregoni se si mund të shfrytëzohet rryma elektrike sigurt. Tregoni/ ngjisni postaret nëpër klasë.</p>	<p>Letër dhe stilolaps</p> <p>Hamera ( letër e madhe) materiale nga arti figurativë – lapsa me ngjyra ose laps, ngjyrë, matrica për të shënuar shkronja.</p> <p>Aplikacion kompjuterik</p>	<p>Siguria gjatë shfrytëzimit të rrymës elektrike: kontrolloni nëse ka tela të këputura ose të zhveshura, pyetni një të rritur si funksionon dhe ai tua kyçi në prizë, mos tërhiqni kordonë – pengim dhe rrëzim, mos e kapni me duar të lagura!</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b></p> <p>Elektrike / rrymë            Siguri            Rrezik            Ndriçim  <b>Hulumtim shkencor</b>            Shikon            Bisedon            Pyet</p>

<p><b>Jave etretë</b> Identifikon burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin.</p> <p><b>Hulumtim shkencor Idetë dhe provat/faktet</b> Shfrytëzo provoja nga përditshmëria, psh vëzhgimin e shkrirjes së akullit.</p> <p><b>Shqyrtimi i provave/fakteve dhe qasjes</b> Bëni krahasim.</p>	<p><b><u>Ora e 6: Festime me ndriçim</u></b></p> <p>Këndoni një këngë e cila këndohet me rastin e ndonjë feste ( ose lëshoni nxënësve të dëgjojnë pjesë të ndonjë kënge që lidhet me festival ose kremtimeve) ku shfrytëzohet ndriçimi si pjesë e ceremonisë (p.sh për të festuar ditëlindjen, Vitin e Ri, etj.)</p> <p>Me të gjithë klasën bisedoni për festimet, festivalet në të cilat ka ndriçim, për atë se ku dhe kur festohen. Këmbeni provoja personale nga këto festivale ose festa. Thuaju nxënësve që të sjellin fotografi që të mund ti tregojnë.</p> <p>Tregoni fotografitë (libra ose internet) nga festivalet dhe ndriçimi që është përdorur atje. Bashkë me fotografit shtoni edhe objekte të ndryshme karakteristike për festime / festivale konkrete. Nxënësit në çift bisedojnë për atë se kujt feste i takojnë fotografit dhe objektet të cilat janë përdorur.</p>	<p>Muzikë ose këngë ose sistem muzikor</p> <p>Fotografi nga festivalet ku përdoret ndriçimi</p>	<p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Festival Festë Ceremoni ndriçim <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Tregon Shkruan Krahason</p>
--	--	---	---

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
	<p>Përsëri shfaqni festimin ose një pjesë të ceremonisë duke shfrytëzuar objektet që i keni në dispozicion dhe përgatisni maska/veshje.</p> <p>Lexoni tregimin në të cilin përmendet drita dhe errësira. Bisedoni me nxënësit për ndjenjat e tyre kur ju lexoni për dritën dhe kur ju u lexoni për errësirën.</p> <p>Vizatoni burimet e ndryshme të dritës duke i lidhur me tradita maqedonase si dhe me festime/ festivale të ndryshme nëpër botë. Bisedoni për ngjashmërinë dhe dallimet mes tyre.</p>	<p>Objekte</p> <p>Libra me përralla shkrepëse</p> <p>tabaka me rërë – për siguri</p> <p>letër dhe lapsa</p>	<p><b>SIGURI</b> – Të gjitha zjarret e pambrojtura më së miri të përdorni pjatë me rërë, psh., pjata e mbushur me rërë të thatë. Nxënësit duhet të rrinë larg zjarrit.</p>

Qëllimet e mësimimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
<p><b>Java e katërt</b> Mund të identifikojë hije. <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Idetë dhe provat/faktet</b> Mblidh fakte me vëzhgim kur përpqet të përgjigjet ndonjë përgjigje shkencore. Shfrytëzo provoja e përditshme.</p>	<p><b>Ora e 7: Hija</b> Dilni jashtë. Tregoni nxënësve që të qëndrojnë me shpinë të kthyer kah Dielli. Vështroni hijen tuaj.</p> <p>Luani lojëra me hijet: bëni hijen më të madhe/më të vogël që mundeni. Pyesni nxënësin a mund të ikin nga hija e tyre dhe të përshkruajnë/tregojnë saktë se si mund ta arrijnë që ta bëjnë atë. Realizoni hije të ndryshme – vëzhgoni hijen tuaj dhe hijen e shokëve tuaj.</p> <p>Nxënësit kanë për detyrë ti vizatojnë hijet që do ti gjejnë në oborrin e shkollës. Gjithashtu, kanë për detyrë të shkruajnë një fjali se si janë çliruara nga hija e vetë.</p> <p>Përkufizim: Hija bëhet kur Dielli shndrit kah ne, por nuk mund të kaloj përmes trupit, dhe ashtu krijon forma të errëta, që ne e quajmë hije.</p>	<p>Ditë me diell në ambient të jashtëm</p> <p>Tabelë me letra të prera për të vizatuar dhe lapsa</p>	<p>Diskutoni rreziqet që kanë të bëjnë nëse e shikoni Diellin në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> <p>Propozoni mbajtjen e kapelave / syzave të diellit dhe losionin.</p> <p>Shpjegoni se hijet formohen kur drita është e mbuluar ose nuk mund të kalojë</p> <p>Burimet e dritës mund të jetë Dielli, por dhe burime të tjera të dritës.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Hije Dritë Diell <b>Hulumtim shkencor</b> Shikoni Tregoni Pyesni Parashikoni krahasoni</p>
<p><b>Java e katërt</b> Mund të identifikojë hijen. <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Marrja dhe prezantimi i fakteve</b> Jep shembuj për mbledhjen e provave/ fakteve.</p> <p>V1.003/14</p>	<p><b>Ora e 8: Bëi hije!</b> Luani disa lojëra me hije si në orën paraprake. Bëni dallim për hijet: psh: e tërhequr, e hollë, e shtypur, e gjatë etj. Identifikoni hijet që janë prej objekteve: ndërtesa, vetura etj. Pyetja deri tek nxënësit është: Çfarë dini se kush e bënë hijen?</p> <p>ScienceGrade2</p>	<p>Hapësirë jashtëdhe me diell</p>	<p>Shpjegoni që hija çdo herë e merr formën e objektit që e bën, por mund të jetë më e gjatë, më e shkurtër, më e gjerë ose më e ngushtë.</p> <p>12</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
Shfrytëzoni mënyra të ndryshme për tu treguar të tjerëve çfarë ka ndodhur.	Bëni hyrje për termin „rreze” që ta përshkruani rrugën e udhëtimit të dritës në linja të drejta. Tregoni nxënësve si mund të krijojnë njeri fëmijë ose kafshë nga hija. Gjithçka fillon duke vizatuar formën e njeriut/fëmijës ose kafshës në një kartonë më të hollë. Pastaj ngjyrosni dhe priteni. Nga ana e pasme me ngjitëse vendoset në një shkop të hollë. Nxënësit dalin jashtë që dielli të ndriçojë tek format. Shihen hijet të cilat janë krijuar nga format të cilat i përgatiten nxënësit. Diskutohen nëse a mund të bëhen më të mëdha, përkatësisht më të vogla. Në grup nxënësit mund të përgatisin përralla dhe ta realizojnë si shfaqje me hijezimet.	Letër Gumë e gjallë Ngjitëse gërshërë	<b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Hije Dritë Rreze Hije nga format <b>Hulumtim shkencor</b> Shikoni Tregoni Pyesni krahasoni

<p><b>Java e pestë</b> Mund të identifikoj hije. <b>Hulumtim shkencor</b></p> <p><b>Shqyrtimi i fakteve dhe qasjes</b> Identifikon modele të thjeshta dhe asociacione. Shikon dhe shpjegon çfarë ndodhen.</p>	<p><b>Ora e 9: Identifikimi i hijeve</b> Ftoni nxënësit që të krijojnë forma të cilat do të krijojnë hije të kafshëve në ekranin e klasës. Paraprakisht, tregohuni si bëhen zogjtë – gërshetoni gishtat tregues dhe lëvizni duar / struci - – shfrytëzoni duar për pjesa e sipërme të sqepit dhe gishtin e madh për pjesën e poshtme të sqepit që të realizohet lëvizje. Mundoheni që ta bëni hijen më të madhe edhe më të vogël. Diskutoni se çfarë do të kishte ndodhur – nxisni nxënësit ti shpjegojnë dallimet në madhësinë e hijes me largësinë e objektit nga burimi i dritës.</p> <p>Në çifte: mendoni një përrallë dhe me ndihmën e duarve bëni hije dhe tregojani nxënësve të tjerë . Si e bëjmë që hija të duket më e madhe ose më e vogël? Luani lojë: shfrytëzoni objektet nga përditshmëria që të realizoni hije. Përgatisni listë punuese që kërkon nga nxënësit të identifikojnë cili objekt cilën hije e ka bërë.</p>	<p>Projektor dhe ekran</p> <p>Listë punuese</p>	<p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Hije Forma</p> <p><b>Hulumtim shkencor</b> Shikoni Ritregoni/tregoni Pyesni Identifikoni</p>
---	---	---	--

<p><b>Java e pestë</b> Mund të identifikoj hije. <b>Hulumtim shkencor</b></p> <p><b>Idetë dhe faktet</b> Përdorë provoja nga përditshmëria.</p> <p><b>Faktet e fituara dhe prezantimi i tyre</b> Vëzhgon dhe i shkruan gjërat që i vëzhguat.</p>	<p><b>Ora e 10: Hulumtimi i hijes</b></p> <p>Në çifte nxënësit bisedojnë për atë se kush e krijon hijen më të mirë, cilat materiale e krijojnë hijen më të mirë. Jepuni shembuj: druri ose gota, letra ose metali etj. Ndhimohuni nxënësve që vetë të mendojnë pyetje për hulumtim se cili material krijon hijen më të mirë.</p> <p>Konkluzion: Cili ishte materiali më i mirë dhe pse? Në listën e punës nxënësit shkruajnë se çfarë ndodhi, si dukeshë hija, japin shpjegime pse hijet janë të ndryshme dhe shkruajnë se cilat materiale krijojnë hijen më të mirë.</p>	<p>Materiale dhe shembuj për të bërë krahasimin</p> <p>Listë për planifikimin e hulumtimit</p>	<p>Hijet më të mira krijohen kur drita nuk mund të kalojë përmes objektit të fortë.</p> <p>Sugjerime: Cilat materiale (x ose z) bënë hijen më të mirë? A është më mirë druri ose letra? Etj. Sigurohuni që u keni dhënë materialet të dukshëm dhe të patejdukshëm që të mund të bëjnë krahasimin – mos i shfrytëzoni këto fjali me ata.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Hije Material <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Tregon Qëllon E drejtë Jo e drejtë Mat Krahason</p>
--	---	--	---



Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
<p><b>Java e gjashtë</b> Mund të identifikoj hije.</p> <p><b>Hulumtim shkencor</b></p> <p><b>Idetë dhe faktet</b> Mbledh fakte përmes vëzhgimit dhe mundohet të jap përgjigje për një nga hulumtimet shkencore.</p> <p><b>Shqyrtimi i fakteve dhe qasja</b> Fletë për parashikimet (gojarisht dhe me test) për rezultatet dhe pse ata ndodhin,</p>	<p><b>Ora e 11: E dukshme ose e?</b></p> <p>Luani lojëra me hije të ngjashme siç në orën e mëparshme. Në çift diskutoni se si hijet bëhen më të mëdha dhe më të vogla. Luani lojë: në grupe nxënësit kanë si detyrë të bëjnë hije psh., të biçikletës, karriges, enës për fruta, të ndonjë shkronje etj. Jepni shpërblime të vogla grupit i cili realizon hije interesante.</p> <p>Përsërisni se cila lloj materiale krijojnë hije më të mira. Nëse është ditë e vrenjtur, krahasoni hijet me ata të cilat i krijuat në një ditë me diell.</p> <p>Aktivitet: Parashikoni dhe hulumtoni cilat materiale janë të dukshme dhe cilat jo. Bëni hyrje në termet: e dukshme, depërton pak dritë ose nuk depërton aspak dritë. Shfrytëzoni materiale të ndryshme dhe krahasoni që të mund të shikojnë se sa dritë depërton përmes tyre. Parashikoni para punës praktike.</p>	<p>Ditë me diell në ambient të hapur</p> <p>shpërblime</p> <p>Materiale të ndryshme që ti përdorni për testimin</p>	<p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> E dukshme Hije Material</p> <p><b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Tregon Shkruan Qëllon Krahason Parashikon Hulumton</p>

## TEMA:2. 2Energjia Elektrike

Kjo temë i njofton nxënësit me konceptin e energjisë elektrike dhe si të shfrytëzohet në jetën e përditshme.

Gjithashtu i njoftojë me rreziqet që janë të lidhura me përdorimin e energjisë elektrike dhe si mund të shfrytëzohet në mënyrë të sigurt.

Hulumtimet shkencore janë fokusuar në:

- të menduarit se çfarë pritet të ndodh dhe nëse rezultatet mbështesin parashikimet
- hulumtim dhe testimi i veturave elektrike
- kryerja e vëzhgimit dhe të sqarohet se çfarë është zbuluar

Qëllimet e mësimit	Shprehje
<p><b>Idetë dhe faktet</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Mbledh fakte përmes vëzhgimit dhe mundohet të jap përgjigje për një nga hulumtimet shkencore</li><li>- shfrytëzon provoja nga përditshmëria, psh. vëzhgimi i shkrires së akullit</li><li>- shfrytëzon burime të thjeshta të informacionit</li></ul>	Bateri Qeli Mbajtës baterish Kordon për rrymë Llambë Tel Konektues Ndërprerës
<p><b>Planifikimi i punës hulumtuese</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- parashtron pyetje dhe propozon mënyra se si mund të përgjigjet</li><li>- parashikon se çfarë do të ndodh para se të vendos çfarë do të bëjë</li></ul>	<b>Hulumtim shkencor</b> Kërkon Bën (përpunon) E qëllon (parashikon)
<p><b>Mbledhja dhe prezantimi i fakteve</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- dhënia e propozimeve për mbledhjen e fakteve</li><li>- fletë për rreziqet dhe si mund të tejkalohen</li><li>- vëzhgon dhe mbanë shënim vëzhgimet</li><li>- realizon matje të thjeshta</li><li>- shfrytëzon mënyra të ndryshme që tu tregojë të tjerëve se çfarë ka ndodhur.</li></ul>	
<p><b>Shqyrtimi i fakteve dhe qasja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- bën krahasim</li><li>- identifikon modele të thjeshta dhe asociacione</li><li>- fletë për parashikimet (gojore dhe më teste), për përfundimet dhe pse ka ndodhur</li><li>- rishikon dhe shpjegon çfarë ka ndodhur</li></ul>	

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
<p><b>Java e gjashtë</b> Aftësi për të prezantuar elementet e qarqeve të thjeshta duke e përfshirë edhe baterinë .</p> <p><b>Hulumtim shkencorë</b> <b>Idetë dhe faktet</b> Mbledh fakte përmes vëzhgimit dhe mundohet të jap përgjigje për një nga hulumtimet shkencore</p>	<p><b>Ora e 12: Si punon drita e dorës</b> Nxënësit punojnë në grupe. Kanë për detyrë që ta bëjnë dritën e dorës që të ndriçojë. Lejojuani që ti ndryshojnë bateritë ose llambën nëse mendojnë se ajo do të pësojë ndryshim.</p> <p>Diskutoni burimin e energjisë elektrike (bateritë) dhe rrjedhjen e energjisë elektrike nga bateritë deri tek llamba. Bisedoni për atë se si punon ndërprerësi. Mundoheni përmes aktiviteteve interaktive.</p> <p>Emërtoni pjesët e dritës së dorës. Vizatoni një skicë të dritës së dorës. Përshkruani se çfarë u duhet që të ndriçojë llamba</p>	<p>Dritë dore Bateri Llambë</p> <p><a href="http://www.eon-uk.com/EnergyExperience/134.htm">http://www.eon-uk.com/EnergyExperience/134.htm</a></p> <p>Letër dhe lapsa</p>	<p>Ndryshoni bateritë tek drita e dorës ose rrotullojeni llambën ose mos vendoni bateri në të, ose merrni dritën e dorës me llambën e djegur me qëllim që të mos ndriçojë kur ta aktivizoni ndërprerësin.</p> <p>Përshkruani se si ky proces është i njëjtë për çdo qark elektrik – dritat e veturës, laptopit, TV etj.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Dritë dore Llambë Bateri Dritë Ndërprerës burim <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Bën (konstrukton) Qëllon (parashikon)</p>

<p><b>Java e shtatë</b> Njeh elementet e qarqeve të thjeshta duke e përfshirë edhe baterinë <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Mbledhja dhe prezantimi i fakteve</b> vëzhgon dhe mbanë shënim vëzhgimet Planifikon punë hulumtuese Parashikon se çfarë do të ndodhë para se të vendos se çfarë do të bëjë.</p>	<p><b>Ora e 13: Si të realizoni një qark elektrik</b> Përsëriteni se si e bëtë dritën e dorës si në orën e më pasme. Tregoni komponent të ndryshme të qarkut elektrik – bateri, mbajtësi i batis, telat, lidhës, mbajtësi i llambave. Lejohuni nxënësve që në grup të punojnë me pajisjet. Mundohuni që të vendoni llambë tek mbajtësi i llambës, baterinë tek mbajtësi i baterisë etj. Jepuni çdo grupi nga 1 bateri, 1 mbajtës baterish, 1 llambë, 1 mbajtës llambe dhe vetëm 2 tela. Kërkoni që të realizojnë dy qarqe të ndryshëm – njëri ku llamba ndriçon dhe tjetrin ku nuk ndriçon.</p>	<p>Dritë dore Bateri llambë  pajisje për qark elektrik – bateri, mbajtësi i batis, telat, lidhës, mbajtësi i llambave.</p>	<p>Pajisja duhet të jetë e përshtatshme që të mund të përdoret nga fëmijët e vegjël.  <b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Dritë dore Qark elektrik Mbyllur</p>
---	---	--	---

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
	<p>Vizatoni fotografi për qarkun tuaj elektrik Përfundim: Çfarë u nevojitet që një llambë të ndriçoj? Qarku elektrik duhet të jen i pandërprerë (i mbyllur)</p>	Letër dhe lapsa	<p>Komponentët Bateri / mbajtës baterish Tela Llamba <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Bën (konstrukton) E qëllon (parashikon)</p>
<p><b>Java e shtatë</b> E din se si duhet të përdoret ndërprerësi i qarkut elektrik. <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Shqyrtimi i fakteve dhe qasja</b> Bën krahasime. Identifikon modele dhe shembuj të thjeshtë.</p>	<p><b><u>Ora e 14: Si punon ndërprerësi?</u></b> Nxënësit ndahen në grupe dhe e marrin të njëjtat pajisje nga ora e mëparshme. Kësaj radhe, kërkonin që llamba të ndriçojë dhe të fiket – kjo është përsëritje nga ora e mëparshme. Pyeteni nëse ekziston ndonjë mënyrë më e mirë për të kontrolluar ndriçimin – Çfarë është që e ka tel drita e dorës, dhe nuk e ka tek qarku i rrymës?  Tregohuni ndërprerës të ndryshëm që janë në dispozicion të nxënësve që të mund të zgjedhin. Mundësoni që të përpiqen që të shtojnë një ndërprerës tek qarku i rrymës. A mund të bëjnë që llamba të ndriçojë me ndihmën e ndërprerësit? Lejohuni që disa grupe ti tregojnë qarqet e rrymës pjesëtarëve të tjerë të klasës .  Vizatoni dhe shënoni qarkun e rrymës tuaj.</p>	<p>Pajisje për qark elektrik si më larët , duke përfshirë edhe ndërprerës/a.</p> <p>Letër dhe lapsa</p>	<p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Qark elektrik Bëni qark elektrik Ndërprite qarkun elektrik Ndërprerës Llamba <b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Bën (konstrukton) E qëllon ( parashikon)</p> <p>Lëvizni brenda ambientit, duke i ndihmuar grupeve që kanë vështirësi. Siguroheni që të gjithë nxënësit mundet të bëjnë dhe të shohin një qark me gjithë ndërprerës. Shpjegohuni se si punon ndërprerësi – e ndërpret qarkun dhe e ndalon furnizimin me energji elektrike.</p>
<p><b>Java e tetë</b> E dinë se ndërprerësi përdoret për të ndërpre qarkun elektrik. <b>Hulumtim shkencor</b> <b>Idetë dhe faktet</b></p>	<p><b><u>Ora e 15: Gjej dhe përdorë ndërprerës</u></b> Vendosni një qark elektrik me llamba dhe ndërprerës. Në qark duhet të ketë ndonjë problem të caktuar (psh., Vendosni baterinë gabim, njëri tel nuk është i lidhur etj). Provoni një nxënësit të parashikojnë se çfarë do të ndodh kur do të përdoret ndërprerësi, të mundohen dhe të shohin</p>	Pajisje për qark elektrik	Nëse ka mjaftueshëm pajisje

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjete dhe materiale)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
<p>Mbledh fakte përmes vëzhgimit dhe mundohet të jap përgjigje për një nga hulumtimet shkencore</p> <p>Përdor provoja nga përditshmëria.</p>	<p>Pastaj arsimtari i pyet nxënësit se çfarë mund të bëjnë që llamba të ndriçojë. Kërkoni nga nxënësit të bëjnë ndryshimin e qarkut.</p> <p>Në çift nxënësit bisedojnë për punët që kanë ndërprerës. Shikoni shembuj të ndryshëm të ndërprerësve në ambientin si p.sh: dritën e dorës, llambë, kompjuter, kamerë digjitale etj.</p> <p>Përgatisni listë punuese në të cilën nxënësit duhet të identifikojnë tre lëndë të ndryshme të cilët janë ndërprerës dhe ta përshkruajnë si punon lloji i ndërprerësit – shikoni komentimet.</p>	<p>Llamba, kompjuter, kamerë, dhe objekte të tjera që kyçen</p>	<p>Aktiviteti mund të bëhet në grupe ku çdo grup ka probleme të ndryshme në qarkun e tyre elektrik. Tregohuni pjesës tjetër të klasës se si mund të mbyllet një qark elektrik.</p> <p>Ndërprerësi mund të shtypet, tërhiqen, shtyhen ose të rrëshqasin për të punuar. Shfrytëzoni këto fjalë që ti përshkruani llojet e ndryshme të ndërprerësve.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b>  Qark rryme  Llambë  Ndërprerës  Përgatitja e qarkut elektrik  <b>Hulumtim shkencor</b>  Shikon  Bën (konstrukton)  E qëllon ( parashikon)</p>

<p><b>Java e tetë</b> Njeh elementet e qarqeve të thjeshta duke e përfshirë edhe baterinë</p> <p><b>Hulumtim shkencor Idetë dhe faktet</b> Mbledh fakte përmes vëzhgimit dhe mundohet të jap përgjigje për një nga hulumtimet shkencore Përdor provoja nga përditshmëria.</p>	<p><b>Ora e 16: Bateri të ndryshme</b> Trego lloje të ndryshme të baterive - Pyesni nxënësit nëse ata e dinë se si të përdorin çdo lloj të baterive ku mund ta gjej ? Luajnë lojë në nivele më të vështirë → Në çifte apo grupe – vendosni bateri në një vend të caktuar të një aparateve elektrike dhe hiqe ose zëvendësoje baterinë dhe kontrolloni nëse pajisja ende punon . Përgatitni listë pune : Në kolonën e parë vendosni fotografi nga objektet e ndryshme / aparate elektrike, ndërsa në kolonën e dytë vendosni llojet e ndryshme të baterive . Nxënësit kanë për detyrë që ti të lidhin objekte / aparatet elektrike me llojin e duhur të baterisë . Disa pajisje elektrike mund të punojë edhe me bateri edhe me energji elektrike . Shpjegoni se si është e dobishme fuqinë e baterisë kur energjia elektrike nuk është në dispozicion , dhe kur na jap liri për të lëvizur rreth me pajisje elektrike ( kur bateria është e mbushur) .</p>	<p>Zgjedhni bateri të ndryshme – cilindrike, 9v, të rrafshëta/ rrumbullake, bateri të veçanta <a href="http://www.bbc.co.uk/bitesize/ks1/science/electricity/play/">http://www.bbc.co.uk/bitesize/ks1/science/electricity/play/</a></p>	<p>Shpjegoni se ka lloje të ndryshme të baterive, si ka lloje të ndryshme të ndërprerësve. Përshkruani baterinë e laptopit apo celular si bateri të veçanta.</p> <p><b>Shprehjet/nocionet kryesore</b> Bateri Aparate elektrike Rrymë elektrike Fuqia e baterisë cilindrike 9v E veçantë</p> <p><b>Hulumtim shkencor</b> Shikon Bën (konstrukton) E qëllon ( parashikon)</p>
---	--	---	--

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Nocione
<b>Fizika (Drita dhe errësira)</b>			
